Buletini I - Korrik 2018

Realizohet video sensibilizuese “Këndet e ëndrrave”

Prishtinë, 15 korrik – Kjo video është një tregim i disa vullnetarëve që krijojnë ambiente të punës të quajtura “Këndet e ëndrrave” të cilat janë të pajisura me mjete të nevojshme pune. Këto kënde të krijuara në shtëpitë e fëmijëve të vegjël u ndihmojnë atyre për të mësuar dhe bërë detyrat e shtëpisë.

Projekti është realizuar nga Qendra për Arsim e Kosovës-KEC dhe është mbështetur nga World Forum Foundation dhe Roma Education Fund-REF. Link: https://www.youtube.com/watch?v=4vtxY

Fillon praktika në punë krahas aktivitetit “Lidhja e Shkollave me Biznese”

Prishtinë, korrik – Në kuadër të Programit të financuar nga USAID “Përkrahje Adoleshentëve pas mësimit të rregullt - ASSET” filloi zbatimi i aktivitetit “Lidhja e Shkollave me Biznese”.

Donika Gjini dhe Vlera Muhaxhiri janë nxënëset e para nga Gjimnazi "Hajdar Dushi" në Gjakovë, të cilat janë duke kryer një hulumtim me të rinjtë e Gjakovës në kuadër të punës praktike në "Kolegji Universum Gjakovë". Qëllimi i këtij aktiviteti është që nxënësit të përfitojnë shkathtësi praktike për jetë dhe punë përmes ndërmarrjeve të ndryshme vendore.

Programi ASSET menaxhohet nga Qendra për Arsim e Kosovës-KEC në partneritet me Fhi360 dhe Crimson Capital Corp.

Fushatat vetëdijësuse për regjistrim të fëmijëve në shkolla

Gjatë muajit korrik, në kuadër të projekit EU SIMRAES 2 "Përkrahja e BE-së për zbatimin e strategjisë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian", kanë vazhduar fushatat vetëdijësuese për identifikimin dhe regjistrimin e fëmijëve në shkolla, në nivelin parafillor, fillor dhe të mesëm të lartë. Qendrat Mësimore (QM) të projektit përmes shpërndarjes së materialeve promovuese si posterë, fletëpalosje dhe broshura të cilat përmbajnë informata rreth procesit të regjistrimit, kanë organizuar vizita derë më derë, takime në lagje, takime me prindër dhe fëmijë me qëllim të informimit rreth rëndësisë së edukimit në jetën e fëmijëve dhe motivimit për regjistrim me kohë në shkollë dhe po ashtu i kanë ndihmuar prindërit në përgatitjen e dokumenteve të nevojshme për regjistrim. Gjatë këtyre aktiviteteve, koordinatorët e QM-ve kanë punuar ngushtë me aktivistët e komunitetit, tutorët, fasilitatorët, shkollat, DKA-të dhe OJQ-të tjera për të siguruar që procesi i regjistrimit për vitin shkollor 2018/19 të jetë i suksesshëm. Lidhur me fushatën e regjistrimit për nivelin parafillor dhe fillor, Qendra Mësimore në Brekoc, Gjakovë, përmes Grupit Këshillues të Komunitetit, ka realizuar një spot informues i cili mund të shikohet këtu https://www.youtube.com/watch?v=XkJ0LaGXN0E

Programi Veror: Aktivitete edukative dhe argëtuese

BSFK organizon tradicionalisht për më shumë se një dekadë Programin Veror që zgjatë 4 javë , e në të marrin pjesë qindra fëmijë në të gjitha qendrat. Programi ndihmon fëmijët që të mos e ndjejnë shkëputjen e gjatë nga shkolla gjatë muajve te veres, si dhe të ruajnë mprehtësinë akademike për vitin vijues akademik.

Rrjeti i Qendrave për Mësim-nxënie ka filluar aktivitetet e programit veror 2018, i cili po mbahet njekohesisht në 5 qendrat e rrjetit. Deri mw tani, janw zhvilluar temat:

- Superheronjwt
- Energjia jonw
- Pikturoj botwn rreth meje
- Rreth botws,
- Sporti, etj.

https://www.youtube.com/watch?v=4D9V1BB2QvY

Trupa teatrale zvicerane 'MaMaFeLe' nga Gjeneva pjesë e programit veror

Risi e këndshme e programit veror të organizuar nga BSFK ka qene edhe sjellja e trupës teatrale zvicerane 'MaMaFeLe' nga Gjeneva, e cila do të organizoj mbi 10 shfaqje dhe punëtori me fëmijet dhe stafin e qendrave. Shfaqja e parë premierë me titullin 'Njeriu që mbolli drunjë', trajton temën e pyllëzimit dhe rëndesinë e ruajtjes së drunjëve, shfaqje kjo që u dha për publikun në Shtime.

Gjithashtu, MaMaFeLe realizoi shfaqje të tjera në Obiliq, Fushë Kosovë dhe Plemetin. Këto shfaqje mblodhën shumë fëmijë si vizitorë. Të gjitha shfaqjet kishin mesazhe vetdijësuese dhe në të njejtën kohë ishin argëtueses për fëmijët.

Fushatë Avokuese me Komunitetin për sfidat e arsimit fillor

Kliqinë/11 korrik - Me pjesëmarrjen e disa nga familjet e nxënësve, zyrtarit komunal për gjithëpërfshirje, përfaqësuesve të Këshillit të shkollës dhe Këshillit të Prindërve, dhe me organizim nga “Syri i Vizionit”, në shkollën fillore “Naum Veqilharxhi” në Kliqinë u realizua një takim për të diskutuar rreth nevojave aktuale të kësaj shkolle, ecurisë dhe sfidave të procesit mësimor si dhe rolit të Këshillit të Shkollës dhe atij të Prindërve në përkujdesjen dhe trajtimin e çështjeve të ndryshme edukative që kanë të bëjnë me nxënësit dhe shkollën në përgjithësi.

Ky aktivitet u realizua në kuadër të programit "Mbështetje në Integrim dhe Fuqizim të të kthyerve Romë, Egjiptianë dhe Ashkalinjë, përmes zhvillimit të kapaciteteve në arsimin fillor, Kosovë" – i mbështetet nga GIZ-i që realizohet nga Syri i Vizionit

Trajnimi për regjistrimin e vonshëm të fëmijë dhe identifikmin e dhunës

Bogë/Pejë, 4 korrik- U mbajt trajnimi për punonjësit e Qendrave për PunëSociale nga komunat Pejë, Klinë, Gjakovë, Prizren dhe Gjilan, në tematikat:"Procedurat e regjistrimit te mëvonshëm të fëmijëve" dhe "Identifikimi dhepërcaktimi i llojeve të dhunës, përfshirë dhunën psikologjike dhe emocionale".

Qëllimi i këtij trajnimi është ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve tëQendrave për Punë Sociale në ofrimin e shërbimeve sociale sa më profesionaledhe me kohë për fëmijë dhe familje, për tëidentifikuar, parandaluar, dhe reaguar ndaj rasteve të dhunës ndaj fëmijëve dhenë menaxhimin më të mirë dhe regjistrimine tyre.

Ky trajnim është organizuar në kuadër të programit tematik në fushën embrojtjes së fëmijës "Detyrimi ynë për të Ardhmen - Mbrojtja e Fëmijës dhe Qeverisja e të Drejtave të Fëmijës", që Syri i Vizionit në partneritet më Savethe Children zyra në Kosovë janë duke implementuar në Kosovë

Organizimi i kampeve verore për të rinjët më trajnimin "Zgjidhja e Konfliktit"

Prishtinë, korrik- VoRAE (Voice of Roma, Ashkali and Egyptians) edhe këtë vit organizon kampe (2) dy ditore më të rinjët e komuniteve: rom, ashkali, egjiptian dhe atyre shqiptar në Brezovicë.

Qellimi i kampit është që të rinjët nga kombësit e ndryshme të ndajn mes tyre përvojat jetësore, dhe se si ato mund të menaxhohen pa konflikte. E gjithë kjo mundësohet në udhëheqjen e trajnimit të Ekspertit i cili gjatë gjithë këtyre 20 ditëve, me nga 15 grupe të ndryshme të cilat grupe vijn nga të gjitha komunat e Republikës së Kosovës do kenë mundësin të mësojnë edhe më shumë rreth temës "Konfliktet Ndëretnike".

Gjithashtu, të rinjët kanë mundësi të mësojnë edhe rreth aktivitetet tjera si "Orientimi në Natyrë", "Rregullimi i Tendave", lojërat të ndryshme e atraktive ku do t´i përcjellin më shumë se 300 të rinjë nga (10) dhjetë komuna të ndryshme në Kosovë

Përvoja e fituar, shoqëria e krijuar, mësimet e ndryshme, do ti motivojnë të rinjët që do të jenë pjesë e kampeve deri në përfundim, po njëkohësisht mendohet të vazhdoj bashkëpunimi edhe me tutje në mes VoRAE (Voice of Roma, Ashkali and Egyptians) si pjesë e grupeve CABLE dhe të rinjëve nga këto komuna gjatë gjithë kohës.

Ky program mbështetet nga #HDI dhe implementohet nga OJQ-VoRAE (Voice of Roma, Ashkali and Egyptians)

Linku: https://www.facebook.com/photo.php?fbid=1788235631265551&set=pcb.1788235984598849&type=3&theater

Nënshkrimi i Dekleratës së Përbashkët

Prishtinë- Nënshkruhet Deklarata e Përbashkët për përkrahjen e respektimit të kornizës ligjore për përmbushjen e kuotave të punësimit për komunitetet: rom, ashkalinj dhe egjiptian në institucionet publike të nivelit qendror dhe lokal.

Qëllimi i nënshkrimit të kësaj deklarate është që t'ju bëhet thirrje institucioneve në nivel qendror dhe lokal, që të respektojnë Kornizën Ligjore për respektimin e kuotës së punësimit të komuniteteve: rom, ashkalinj dhe egjiptian e cila kuotë ju garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës Neni 61/62 duke vazhduar edhe me ligjin për Shërbim Civil me Nr 03/L-149 Neni 11, dhe Ligjin e Punës Nr.03/L-212, si dhe Rregulloren Nr.04/2010 për procedurat e përfaqësimit të drejtë dhe propocional të komuniteteve jo shumicë.

Në këtë tryezë diskutimi të marrjes së vendimit për nënshkrim të deklaratës ishin prezent edhe përfaqësuesit e partive politike nga radhët e komuniteteve: rom, ashkalinjë dhe egjiptian së bashku me përfaqësues të shoqërisë civile të cilët e kanë nënshkruar këtë deklaratë për të ofruar përkrahjen e tyre, që të punohet në këtë drejtim edhe më më shumë seriozitet.

Linku: https://www.facebook.com/photo.php?fbid=1726938490728599&set=pcb.1726939250728523&type=3&theater